

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P. nr.765/18**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICËS-departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gezim Ademi, dhe procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, ne lenden penale ndaj te pandehurve: I.T. nga fsh. ... si dhe Sh.D.nga fsh. ... qe te dy nga Komuna e ..., për shkak te veprës penale Vjedhje e rend nga neni 327 par.1 pika 1.1 ne bashkryerje sipas nenit 31 KPRK-se, sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.II.nr.194/2018 te datës 06.09.2018 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te dt. 25.01.2019, ne mungese te prokurores Jelena Marjanoviq, ne prezence te te pandehurve e te njëjtën dite publikisht shpall ketë, ndërsa me dt. 11.02.2019 përpiloi ketë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri: I.T., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne fsh. ..., Komuna e ..., shqiptar, shtetas i Kosoves, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë, ka te kryer shkollën e mesme.**

**I pandehuri: Sh.D., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne fsh. ..., Komuna e ..., shqiptar, shtetas i Kosoves, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa punë, ka te kryer shkollën e mesme.**

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Gjate natës me dt. 05.02.2017 ne fsh. ... Komuna e ... saktësisht ne shtëpinë familjare te Tezes i dëmtuarit M.M., e cili përkatësisht qëndron ne ... me qellim qe perveti ta përfitojë dobi pasurore kundërligjshme, i dyshuari i pare. Dhe i dyshuari i dyte e kanë marre pasurinë personit tjetër, ne mënyrë qe ne natën e cekur përmes shkalleve te katit te dyte te shtëpisë me përdorimin e forcës, duke thyer xhamat e dritares e cila ka pasur kornizën e plastikes, duke përdorur shrafcigerin si mjet i përshtatshëm, dhe se pas thyerjes te xhamit janë hyre ne shtëpi, kryer rivendesim, demolonin e dhomave ne te cilin kane hasur, dhe prej shtëpisë kane marrur televizorin ngjyre te zeze te tipit TELEFUNKEN, dhe pastaj janë dale nga shtëpia, dhe nga garuzhda kane marre prerësen e barit ngjyre te zeze, e kane thyer cilindrin e derës te veturës, kane hyre ne automjet, kane hapur hauben kane marre akumulatorin e automjetit, dhe pas kryerjes te sendeve te vjedhura kane vendosur ne shtëpinë e vjetër, e kurse ditëve te ardhshme pos televizorit kane shitur ne deponi te hekurave për 20 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Vjedhje e rend nga neni 327 par.1 pika 1.1 ne bashkryerje sipas nenit 31 KPRK.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,41,45,46,73, dhe 327 par 1 pika1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dhe nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës i:

**G J Y K O N**

**I.Te Pandehurin: I.T.**

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej (3) vite, dhe me dënim me gjobe ne shume prej (400 euro), i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

## **II. Te Pandehurin: Shkëlzen Deliu**

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej (3) vite, dhe me dënim me gjobe ne shume prej (400 euro), i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

OBLIGOHEN te pandehurit qe ne emër te shpenzimeve procedurale - paushallit gjyqësor te paguan secili veq e veq shumen prej 30 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 30 euro te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguajnë ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike – kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore ne Mitrovice** - ka ngritur aktakuze PP.II.nr.194/2018 te datës 06.09.2018, kundër të pandehurve I.T. nga fsh. ... si dhe Sh.D. nga fsh. ... qe te dy nga Komuna e ..., për shkak te veprës penale: Vjedhje e rend nga neni 327 par.1 pika 1.1 ne bashkryerje sipas nenit 31 KPRK-se.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë te pandehurit: e kane pranuar fajësinë duke theksuar se e ndjejnë veten fajtor për veprën penale që ju vihet në barrë.

Prokurori lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se e pranoj pranimin e fajësisë për te dy te pandehurit I.T. dhe Sh.D. nga se te njëjtit pranimin e fajësisë e kane dhen ne mënyrë vullnetare dhe se te njëjtit e kane pranuar fajësinë sipas shkresave dhe fakteve qe gjenden ne lende dhe atë i propozoj gjykatës se me rastin e shqiptimit te dënimit ta merr parasysh pranimin e fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi qe te pandehurit kuptuan natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë te pandehurit e bënë në mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike qe do të bënin të pamundur që gjykata të beje vlerësimin e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga te pandehurit është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, e që konkretisht mbështetet ne provat materiale si; Raporti policor nr. 2017-BC-109 nga dt. 05.02.2017, deklarata e dëshmitarit dt. 05.02.2017, deklarata e te pandehurit I.T. e dt. 08.05.2017, deklarata e te pandehurit Sh.D.e dt. 25.05.2017, deklarata e dëshmitarit M.T. dt. 27.03.2017, raporti i mbikëqyrjes se vendit te ngjarjes i dt. 05.02.2017, si dhe vështrimi i foto dokumentacionit. të gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes së akuzës njëkohësisht janë me përputhjen e pranimin të fajësisë nga te pandehurit, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurve.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke u bazuar ne nenin 73 te KPRK-se, ashtu qe kjo gjykatë pate parasysh lartasin e dënimit qe për këtë veprë penale minimumi i dënimit është 3 vite ndërsa maksimumi i dënimit për këtë veprë penale është 7 vite, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka

gjetur shkallen e përgjegjësisë penale për te dy te pandehurit gjë që nga provat rezulton se te pandehurit këtë vepër e kishin kryer me dashje direkte e që është shkalla me e lartë e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që në këtë rast është pasuria, e që kjo vepër penale ka qëllim të mbrojtë të mirën materiale-pasurin, rrethanat dhe mënyra më të cilat është kryer vepra po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë renduese për te dy të pandehurit edhe faktin se te njëjtit janë te njohur për policin sipas shkresës mbi informacionin nga policia ku sipas tij te pandehurit evidentohen për vepra penale te natyrës se njëjtë dhe te ndryshme, po ashtu gjykata murre parasysh edhe faktin se këto vepra penale janë ne rritje permanente. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale, ndërsa për veç kësaj gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimit e fajësisë e që nga deklarimi i tyre me rastin e pranimit të fajësisë rezulton se e ndien vetën fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurve për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tyre për veprën penale.

Nga gjitha këto gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurve pasi që për gjykatën në rrethana te tilla mjafton se me shqiptimin e këtij dënimi do te arrihet qëllimi i dënimit që te parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen si dhe ti parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe kompensimin e viktimave për humbjen ose demin e shkaktuar nga vepra penale, si dhe një kosisht ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Po ashtu prokuroria ka njoftuar gjykatën me shkresën e saj se gabimisht ka paraparë ne piken tre te aktakuzës për masën e arrestit shtëpiak, nga se te pandehurit fare nuk kane qen ne arrest shtëpiak, e po ashtu edhe gjykata me rastin e shikimit te shkresave te lendes konstatoi se gabimisht ekziston kjo kërkesë nga ana e prokurorisë se te njëjtit nuk kane qen nen ketë mase.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që ti obligoj te pandehurit që te paguajë shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguan secili veq e veq shumen prej 30 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimi te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 30 euro te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar që ti paguajnë ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarin e ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.765/2018 dt.11.02.2019**

Procesmbajtësja:

Hasnije Muhaxheri

**Gjyqtari i Vetëm Gjykues**

Gezim Ademi

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë në ankese në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë- nëpërmes kësaj gjykate.